



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E VLERËSIMIT

NJOFTIM

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR HARTUES TË FONDIT TË
PYETJEVE TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE**

Për të gjithë kandidatët aplikantë për hartues të fondit të pyetjeve të provimeve të maturës shtetërore, ju bëjmë me dije se trajnimi do të zhvillohet në QSHA, në datat: 14 nëntor 2020, ora 09.00 deri më 14.00, për kandidatët e lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi, dhe 21 nëntor 2020, ora 09.00 deri më 14.00, për kandidatët e lëndëve të tjera.

Kandidatët që kanë plotësuar kriteret për hartues, do të njoftohen në adresat e tyre elektronike, lidhur me datën e zhvillimit të trajnimit.

Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në vijim të masave parandaluese të përhapjes së saj, nëpërmjet urdhrave të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, trajnimi do të zhvillohet duke zbatuar me përpikmëri rregullat e mëposhtme:

Kandidati duhet të respektojë rregullat e distancimit fizik dhe të higjienës.

Në ditën e trajnimit, secili kandidat duhet të mbajë detyrimisht maskën dhe të respektojë distancimin fizik.

Personi i caktuar nga QSHA, kryen për çdo kandidat procedurën si më poshtë:

- i. mat temperaturën me termometër digjital.*
- ii. kontrollon nëse çdo kandidat është i pajisur me maskë.*

Gjatë paraqitjes për pjesëmarrje në trajnim, kandidati duhet të ketë parasysh dhe të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- 1. të jetë i pajisur me dokument identifikimi;*
- 2. të paraqitet i pajisur me maskë;*
- 3. të zbatojë ruajtjen e distancës fizike 1,5 metër nga kandidatët e tjerë;*
- 4. të mos ketë me vete celular, çantë dhe sende të tjera personale të panevojshme për zhvillimin e trajnimit.*
- 5. Kandidati duhet të paraqitet së paku 30 minuta përpara fillimit të trajnimit.*
- 6. Kandidati duhet të mbajë parasysh sa më poshtë:*
 - Të mos **mbajë** dhe **të mos përdorë celular** dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë trajnimit*
 - Ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e trajnimit.*

Ju urojmë Suksese!